



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr: 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.01.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik B-Bardhi SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE B-Bardhi SH.P.K. e datës 27.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 22.01.2025 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 22.01.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik B-Bardhi SH.P.K. me datë 27.01.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 29.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

- Neni 1 - i LPP
- Neni 6 - i LPP
- Neni 59 - i LPP
- Neni 60 - i LPP

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:

Si palë e e pakënaqur me Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 22.01.2025 në lidhje me aktivitetin e prokurimit:

Titulli: "Ndertimi i objektit te ri per Institutin Special ne Shtime" Nr. të prokurimit: 206-24-187-5-1-1

Duke e përfillur afatin ligjor konform ligjit te LPP-së, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë sepse mendojmë se i njëjti ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Gjithashtu AK ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke na shpallur neve si OE i papërgjegjshëm edhe pse I kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Operatori "Raf II" shpk ka dorëzuar ofertën e tij në vlerë prej: 6,299,996.00 e cila krahasuar me ofertën tonë në vlerë prej 5,477,777.77 është për 822,218.23 më e lartë.

Pas qasjes tonë në dokumente zyrtare tek OE "Raf II" kemi vënë re disa parregullsi konkretisht mosplotësimi i disa kërkesave të DT, të cilat në gjendje normale të njëjtin duhet ta shpallnin OE I papërgjegjshëm dhe jo ta rekomandonin për kontratë.

Kërkesa 1.

1. Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses ne teresi projekte te ngjashme nga lamia e punëve në objekte te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë.

Sipas Listes së dorëzuar nga OE "RAF II" kemi vënë re se i njëjti i ka listuar disa projekte më të vjetra se tre vite të cilat edhe ju si AK i keni vlerësuar si të tilla dhe keni kërkuar sqarime shtesë si më poshtë:

Kërkesa për Sqarimet Shtesë të datës 15.01.2025 nga AK për OE:

Në ofertën tuaj keni prezantuar listën me gjashte projekte. Për disa prej tyre nuk janë te kompletuara dëshmitë e realizimit siç janë kërkuar, ndërsa disa tjera nuk janë te realizuara brenda periudhës tre vjeçare siç eshte kërkuar. Kërkojmë sqarime shtese për projektin nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3". Vlera e kontratës ne total 8,390,052.31 euro (6,805,078.51 1,584,973.80), sipas sqarimeve te ofruara nga ana juaj te dates 07.01.2025 ju e keni prezantuar një procesverbal te inspektimit nga tereni i dt. 2 04.05.2024, me nënshkrim vetëm të një inspektori, ndërsa nuk keni dëshmuar raportin e pranimit te punëve nga komuna e Prizrenit.

Për këtë projekt Amelia-Faza 3, kërkojmë të na dëshmoni raportin e pranimit te projektit nga komuna e Prizrenit (me date para hapjes se ofertave), meqenëse vetëm me këtë procesverbal nga tereni nuk plotësohet dëshmia e kërkuar.

Sqarimet e juaja jane me rendesi, duke marre parasysh se nga lista me 6 projekte te ofertes tuaj, tre projektet e me poshtme nuk mund te merren parasysh meqense jane te perfunduara me heret se sa tre vitet e fundit nga Njoftimi per kontrate i dt. 17.10.2024.

- projekti nr. 1 kontrata baze (3,288,438.44 euro) perfundimin e ka ne 2019,
- projekti nr. 2 (4,471,927.39 euro) perfundimin e ka prill 2021,
- projekti nr. 5 (2,940,401.45 euro) perfundimin e ka mars 2021,

Aktualisht ju e mbuloj me deshmi vetem projektet per vleren e pergjithshme 5,103,667.86 euro, si ne vijim:

- aneksi i projektit nr. 1 ne vlere 522,981.13 euro,
- projekti nr. 3 ne vlere 3,524,335.33 euro,
- projekti nr. 6 ne vlere 1,056,351.40 euro.

Pra, deri në këtë pikë kërkesa juaj për sqarim e cila thotë: **"Për këtë projekt Amelia-Faza 3, kërkojmë të na dëshmoni raportin e pranimit te projektit nga komuna e Prizrenit (me date para hapjes se ofertave),**

meqenëse vetëm me këtë procesverbal nga tereni nuk plotësohet dëshmia e kërkuar", është një kërkesë shumë e saktë dhe conform kërkesës së DT e cila thotë: Për çdo projekt te realizuar kërkohen Referencat ose Certifikata e Pranimit teknik.

Pas kësaj kërkesë për sqarim OE ka kthyer përgjigjen e tij në të cilën për projektin e lartëcekur *Amelia-Faza 3*, i ka ngarkuar edhe njëherë procesverbalet e inspektorëve të ndërtimit nga tereni të cilat nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit (Për çdo projekt te realizuar kërkohen Referencat ose Certifikata e Pranimit teknik.) si dhe një dokument (Leter Konfirmimi) të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me datë 17.01.2025, e cila vetëm konfirmon se procesverbalet e njejta janë zyrtare dhe janë përpiluar nga ana e inspektores të cilat janë hartuar si procesverbale finale per Inspektim final, por nuk dëshmon se objekti në fjalë është i pajisur me çertifikatë përdorimi apo pranimteknik.

Pra OE sërish nuk ka paraqitur çertifikatë përdorimi apo pranim teknik sipas kërkesës në DT, andaj projekti nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3". Vlera e kontratës ne total 8,390,052.31 euro (6,805,078.51 1,584,973.80) nuk mund të merret parasysh për ta mbuluar vlerën e kërkuar prej 9 milion Euro sipas kërkesës në DT.

OE në përgjigjen e tij gjithashtu per projektin nr 1 i cili ka kontratën bazë dhe 2 shtojca (Addendume), ka shprehur se *"e njejta kosiderojme qe duhet trajtuar si nje kontrate sepse eshte per te njeitin objekt. Vlera perfundimtare e kesaj kontrate eshte 3,811,419.57 euro."*

Mirepo as ky projekt nuk mund ta mbuloj vleren 9 milion sepse referencat e lëshuara për këtë kontratë dhe aneksin janë dy referenca të ndryshme dhe ajo e kontratës bazë është referencë e lëshuar në datën 2019 ndërsa ajo qe vlen është vetëm referenca e aneksit me vlerën: 522,981.13 euro.

Prandaj kjo pergjigje finale e OE, e cila si duket juve si AK ju ka bindur që këto dokumente dhe përgjigje shtesë mund ta mbulojne vlerën e kërkuar, ne konsiderojmë se të njejtat nuk mund të vlejné pasi që nuk e plotësojnë kërkesën sipas DT e që është shumë e saktë **9 milion Euro** kontrata dhe dëshminë kryesore **Për çdo projekt te realizuar kërkohen Referencat ose Certifikata e Pranimit teknik.**

Prandaj në këtë rast Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP konkretisht pika 4 (Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshnja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm

nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve).

Kërkesa 3. Kërkesa 3. Stafit profesional Inxhinierët Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf profesional te nevojshëm (min. 7 inxhinierë) për realizimin e projektit.

Dëshmia 3. - Lista e stafit profesional - origjinal e nënshkruar dhe vulosur.

Operatori Ekonomik përmes listës së stafit profesional ka deshmuar vetem 6 ingjiniere për realizimin e projektit e jo (min. 7 inxhinierë) siq kërkohet në DT. (shiko listën e OE ku mungon ingjiniere i gjeodezisë).

LISTA E STAFIT PROFESIONAL (INZHINIERËVE) TË KOMPANISË RAFII sh.p.k. QË DO TË ANGAZHOHEN NË PROJEKT

Titulli: " NDERTIMI I OBJEKTIT TE RI PER INSTITUTIN NE SHITIME, NUMRI PROKURIMIT: 206-24-187-5-1-1

Nr.	Emri/Mbiemri	Pozita	Edukimi
1	Hadi Bytyqi	Menaxher i Projektit	Inzhinier i Diplomuar Arkitektures
2	Bleta Berisha	Inzhinier i diplomuar i Arkitektures	Inzhinier i diplomuar i Arkitektures
3	Milot Muhaxheri	Menaxher i Punishites	Inzhinier i Diplomuar Ndermtarës/Konstruktiv
3	Nexhat DAKA	Inzhinier i diplomuar i Makineris	Inzhinier i diplomuar i Makineris
4	Berim Dafa	Inzhinier i Diplomuar i Ndermtarës/ Drejtimi Hidroteknik	Inzhinier i Diplomuar i Ndermtarës
5	Josif KURTI	Inzhinier i Diplomuar Elektroteknikës	Inzhinier i Diplomuar Elektroteknikës



OE e ka ngarkuar ingjinerin e gjeodezisë të cilin nuk e ka listuar fare, por të njejtit nuk i ka paraqitur fare referenca që dëshmojnë përvojën e punës.

Pra nuk e ka plotësuar kërkesën sipas DT. Dëshmitë (3.2 - 3.7) - Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës.

Edhe në këtë pikë AK ka vepruar në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 59 të LPP konkretisht pika 4.

Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit- Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve librezat e qarkullimit me regjistrim, ndërsa për mjetet tjera qe nuk regjistrohen të ofroj si dëshmi dudin doganorë ose faturën me transaksion bankarë mbi shitblerjen.

Sa i përket mjetit - **Makinë për suvatim**, OE "RAF II" ka lidhur një Kontrate furnizimi me makineri me një kompani CANI-EA shpk, e cila ka të bëjë me furnizim me pajisjen **MAKINE PER SUVATIM**. Për

makinerinë e njejtë ka paraqitur vetëm këtë kontratë si dhe 2 fotografi të mjetit dhe nuk ka paraqitur si dëshmi as dudin doganor apo faturën me transaksion bankarë mbi shitblerjen sipas kërkesës së DT.

Ndërsa sa i përket mjetit - **Një (1) autokran me kapacitet bartës min. 10 ton**, OE RAF II ka lidhur një Kontrate furnizimi me makineri me një NPT UNIVERSAL, e cila ka të bëjë me furnizim me pajisjen **2 Vinç me krah kapaciteti bartës min 10tone**. Për makineritë e njejta ka paraqitur kontratën, fotografi të mjeteve dhe dy dud doganor të cilët janë plotësisht të palexueshëm dhe nuk dëshmojnë as pronësinë as karakteristikat e mjetit.

Për të dy mjetet AK i ka kaluar pa kërkuar sqarime shtesë duke shpallur fitues OE i cili me këto dëshmi nuk i ka plotësuar kriteret sipas DT, andaj konsiderojmë së edhe në këtë rast AK ka vepruar kundërligjshëm sipas nenit 59 të LPP, pika 4.

Në anën tjetër mendojmë se Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke na shpallur si tender i papërgjegjshëm edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e

Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Në pikën 2 të arsyetimit në njoftimin për vendimin e AK të dates 22.01.2025 AK konkretisht në letër standarde për tenderuesin e eliminuar na ka shpallur tender i papërgjegjshëm në lidhje me kërkesën 1

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses në teresi projekte të ngjashme nga lamia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohej për liderin e grupit.

Kriteri ka përcaktuar projekte të ngjashme nga lëmia e punëve në objekte të larta, andaj në këtë rast nuk pranohen projektet e realizuara infrastrukturore (rruge, kanalizime, nënkalime të qytetit) Në bazë të projekteve të prezantuara nga "B-Bardhi" shpk të pranueshme janë vetëm një pjesë e tyre me vlerë të përgjithshme 6 milion Euro.



Shërbime juridike
Zemra, Ferizaj
Tel: 042/522-818
email:
shpk.bardhi@gmail.com

LISTA E PROJEKTEVE PER 3 VITET E FUNDIT

No	Titulli i projektit	Investitori	Personi Kontakues	Punëkryesi	Data e fillimit	Data e përfundimit	Vlera (€)
1	Objekti 5 banimi me afarizem B+P+11+PH rr. Bajram e Gursel Sulejmani - Ferizaj	B-Bardhi sh.p.k	Besim Sulejmani shpk.bardhi@gmail.com	"B-Bardhi sh.p.k"	20.10.2021	23.10.2024	1,793,539.57 €
2	"Ndërtimi i stacionit të autobusëve-faza II"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k"	24.10.2022	29.08.2024	929,154.09 €
3	"Ndërtimi i stacionit të autobusëve-faza II - Anëks Kontrata"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k"	03.04.2024	29.08.2024	90,752.40 €
4	"Ndërtimi i qendrës multifunksionale në Ferizaj- projekt tre vjeçar"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k", "Euro-Infrastruktura"	13.08.2020	23.10.2024	1,213,169.38 €
5	"Ndërtimi i stacionit të autobusëve-projekt tre vjeçar"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k", "Euro-Infrastruktura"	30.06.2020	26.06.2023	487,244.76 €
6	"Ndërtimi i stacionit të autobusëve-projekt tre vjeçar - Anëks Kontrata"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k"	23.10.2020	26.06.2023	48,710.00 €
7	"Ndërtimi i Palestrës sportive në fshatin Greme me kapacitet 1000 ulëse -projekt tre vjeçar"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k"	08.08.2018	22.06.2023	1,195,727.24 €
8	"Ndërtimi i Palestrës sportive në fshatin Greme me kapacitet 1000 ulëse -projekt tre vjeçar - Anëks Kontrata"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k"	15.12.2021	22.06.2023	116,595.29 €
9	"Këmbësorë afër stacionit policor në Ferizaj-faza I-rë"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k"	09.12.2022	17.05.2023	433,333.33 €
10	"Vazhdimi i nënkalimit për këmbësorë, dalje në rrugën "Emin Duraku" -projekt dy vjeçar"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k", "Linda sh.p.k", "Euro-Infrastruktura"	29.05.2020	05.10.2022	1,087,038.60 €

11	"Vazhdimi i nënkalimit për këmbësorë, dalje në rrugën "Emin Duraku" -projekt dy vjeçar - Anëks Kontrata"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"B-Bardhi sh.p.k"	06.04.2022	05.10.2022	108,695.60 €
12	"Bashkimi i Qytetit - projekt dy vjeçar"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"Linda sh.p.k", "B-Bardhi sh.p.k", "Beni Com sh.p.k"	17.09.2018	05.10.2022	4,030,290.80 €
13	"Bashkimi i Qytetit - projekt dy vjeçar - anëks kontrata"	Komuna Ferizaj	Arberie Bekteshi prokurimi.ferizaj@rks-gov.net	"Linda sh.p.k", "B-Bardhi sh.p.k", "Beni Com sh.p.k"	30.04.2021	05.10.2022	399,419.50 €
14	Objekti 4 banimi me afarizem B+P+10+PH rr. Gjon Sereqi - Ferizaj	"B-Bardhi" shpk	Besim Sulejmani shpk.bardhi@gmail.com	"B-Bardhi sh.p.k"	31.10.2019	23.08.2022	1,560,000.00 €
Gjithsej vlera e projekteve të ekzekutuara në 3 vitet e fundit							13,434,279.56 €

pozicione nga betoni dhe armatura e që janë pozicione të ngjashme me lëminë e punëve sipas kërkesës. Madje në njërin nënkalim ekzistojnë lokale afariste të cilat janë finalizuar me të gjitha punët përcjellëse siq

janë: punët e fasades, punët e dyshemesë, punët e qeramikës, punët e sanitarisë, punët e agjullaturës etj. Këto janë punë tipike të natyrës së ngjashme dhe është e padrejtë të mos llogaritet komplet referenca vetem duke u bazuar në titullin e kontratës. Nëse keni interesim mund tju përcjellim paramasën e punëve apo projektin si dhe fotografi nga tereni në mënyrë që një pjesë e saj të llogaritet si kriter plotësues.

Është shqetësuese se si AK na shpall neve tender të papërgjegjshëm duke i neglizhuar kontratat tona të cilat i plotësojnë kërkesat e DT dhe dëshmitë kryesore që janë raportet e pranimeve teknike e në anën tjetër shpallin fitues një OE i cili ka kontrata pa pranime teknike.

Në pikën 1 të arsyetimit në njoftimin mbi vendimin e AK të datës 22.01.2025 konkretisht në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar AK na ka shpallur tender I papërgjegjshëm në lidhje me kërkesën që ka të bëjë me letrën mbështetëse nga banka:

Sipas letrës mbështetëse të ofruar nga Procredit Bank, nuk ka limit të aprovuar siq është kërkuar por këtë mbështetje bankare e ka të kushtëzuar se: Nëse klienti "B-Bardhi"

kërkon mbështetje financiare për realizimin e projektit.. banka do të konsiderojë mbështetjen financiare deri në 2 milion Euro duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga këshilltarët tanë të kredive për biznese.

Konsiderojmë se kërkesa në asnjë pikë nuk ka pasur të bëjë me kredi të pakushtëzuar por me mbështetje bankare deri në 2 milion euro, të cilën ne e kemi dorëzuar në origjinal sipas kërkesës së DT.

Duke besuar se i kemi elaboruar mjaftueshem shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit ne:

Kërkojmë nga AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat e ligjit te prokurimit public gjithashtu ti respektoj kërkesat e veta te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit dhe te nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : "B-Bardhi" SH.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Titulli: "Ndertimi i objektit te ri per Institutin Special ne Shtime" r i prokurimit: 206-24-187-5-1-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë

ANULOHET njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues i dates 22.01.2025 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Titulli: "Ndertimi i objektit te ri per Institutin Special ne Shtime"

Nr i prokurimit: 206-24-187-5-1-1 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme te konsiderueshme ekonomike të cilat do të kalkuloohen në vazhdimësi.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kërkesën për rishqyrtim te OE ankues:

Pretendimi i parë se OE i rekomanduar nuk i ploteson kriteret e tenderit, eshte i pa bazuar ky pretendim, meqense ne lidhje me kerkesen per realizimin e projekteve te ngjashme nga lamia e punëve në objekte te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë.

OE i rekomanduar i ka prezantuar 6 projekte bazë te realizuara, si dhe aneksi i projektit 1. 3 prej ketyre projekteve te listuara i jane refuzuar tre projekte:

- projekti nr. 1 kontrata baze (3,288,438.44 euro) perfundimin e ka ne 2019,
- projekti nr. 2 (4,471,927.39 euro) perfundimin e ka prill 2021,
- projekti nr. 5 (2,940,401.45 euro) perfundimin e ka mars 2021,

Per projektin nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere **8,390,052.31** euro (6,805,078.51 + 1,584,973.80), janë kerkuar sqarime shtesë dhe bazuar ne dy sqarimet e ofruara nga OE dhe me deshmi nga kumuna e Prizrenit, ky projekt eshte i pranueshem per AK, meqense deshmohet se punet jane kryer, eshte pranuar nga inspektori i ndertimit dhe eshte ne proces per leje te shfrytezimit.

Ne NJK dhe DT nuk kemi kerkuar qe per objekte private te deshmohet leje te shfrytezimit, por kemi kerkuar qe Për investitor privat kerkohet Certifikata e pranimit nga komuna.

Ne baze te sqarimeve te ofruara, konfirmimit nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Inspektorateve, eshte vertetuar procesverbali i pranimit te projektit nga Inspektorja si procesverbal i inspektimit final.

Ku merren parasysh 3 projektet e pranuar fillimisht ne vleren e pergjithshme 5,103,667.86 euro:

- aneksi i projektit nr. 1 ne vlere 522,981.13 euro,
- projekti nr. 3 ne vlere 3,524,335.33 euro,
- projekti nr. 6 ne vlere 1,056,351.40 euro.

si dhe projekti nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere 8,390,052.31 euro, vlere totale e projekteve te realizuara eshte rreth **13.5 milion euro**, andaj OE i rekomanduar e ka tejkualuar kerkesen e AK.

Pretendimi i dytë se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar stafin profesional dhe se mungon ne liste gjeodeti dhe referenca si deshmi, ky pretendim eshte pjeserisht i bazuar, por nga AK kjo eshte konsideruar si devijim i vogel duke marre parasysh se OE i rekomanduar e ka ofruar gjeodetin z. Bardhyl Kryeziu me Para Kontrate per kete projekt, diplome te noterizuar, CV, Licence valide te noterizuar, si dhe forma e pershkrimit te eksperiences se gjeodetit ne dokumentin e deshmuar **Historiku i punesimit** e nenshkruar dhe e vulosur me vulen e gjeodetit Bardhyl A.Kryeziu, jane te pershkruara secili nga projektet e realizuara pres tije, me te dhena te pune kryesit, investitorit, vlere e projekteve, data e fillimit, data e perfundimit, te dhenat e kontaktit te punedhenesit, andaj kjo ka qene deshmi e mjaftueshme per pervojen e gjeodetit sic eshte kerkuar.

Pretendimi i tretë se OE i rekomanduar nuk i ka plotesuar makinerite e kerkuara, ky pretendim eshte i pa bazuar, meqense OE i rekomanduar e ka tejkualuar kete kerkese te AK, duke ofruar makineri te shumta ne pronesi si dhe ne marrveshje dhe kontrata me disa kompani tjera.

Sipas komisionit vlerësues OE i rekomanduar i posedon edhe mjetet qe ju i kontestoni Makine për suvatim; Një (1) autokran me kapacitet bartës min. 10 ton, por dëshmitë rreth këtyre pajisjeve ne ofertën e OE te rekomanduar, janë ne gjuhe te huaja me shume te dhëna dhe shënime dhe eshte mjaft sfiduese identifikimi i sakt i tyre, andaj ne si AK-MSh do ta kemi parasysh qe ne aktivitetet e ardhshme ti shmangim maksimalisht kërkesat rreth makinerisë dhe mjeteve te punës dhe te fokusohemi vetëm te kapaciteti ekonomik dhe financiar, stafi inxhinierik dhe referencat për punët e kryera.


Pretendimi i katert ne lidhje me arsyet e eliminimit te ofertes tuaj, per mos realizimin e projekteve te ngjashme nga lamia e punëve në objekte te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. AK-MSh e konsideron te pa bazuar ketë pretendim, meqense ne baze te projekteve te prezantuara nga ana juaj si konsorcium prej tre OE (B-BARDHI, VALI INVEST, Linda SHPK) vlera totale e punëve te realizuara dhe te pranuar si ndertime te larta sipas kriterit te NJK dhe DT eshte rreth 7.9 milion euro, ndërsa eshte kërkuar te jete jo me pak se 9 milion euro.

Gjithashtu edhe per piken e dyte te eliminimit tuaj, AK-MSh e konsideron se sipas Letrës Mbështetëse te ofruar nga ProCredit Bank ne oferten tuaj, nuk deshmohet se keni limit te aprovuar siç eshte kërkuar, por mbështetja bankare esht me kushtëzim, citoj: "Nëse klienti "B-Bardhi" kërkon mbështetje financiare për realizimin e projektit... banka do te konsideroj mbështetjen financiare deri ne 2 milion euro duke u bazuar ne kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare te bere nga këshilltaret tanë te kredive për biznese. Kërkesa e NJK dhe DT ka qene e kjarte... ose mbështetje bankare (qasje në kredi – limit te aprovuar nga banka) për realizimin e këtij projekti,

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

ZPP, Udhëheqës i Div. te Prokurimit